

Procesverbal

*Nga Mbledhja X (e dhjetë) e rregullt për vitin 2024 e Komitetit për Politikë dhe Financa ,
e mbajtur më datë: 28.10.2024*

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën X; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje, kryetar! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen X të rregullt të KPF-së për vitin 2024! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. Para se ta qesim në votim rendin e ditës, nëse ka dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e qesim në votim rendin e ditës. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Atëherë, vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? A ka abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën X. Miratimi i Raportit të Shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2024. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se nuk ka, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? A ka abstenim? Me 5 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Miratimi i Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024-2028.

Agon Baxhaku: Përshëndetje për të gjithë! Unë do të prezantoj në pika të shkurta Planin e Veprimit për PAK. Ky plan ka kaluar fazën e konsultimit publik dhe sot është në KPF, për të kaluar për miratim në Asamble. Sot para nesh kemi këtë Plan, i cili është rezultat i një angazhimi të përbashkët dhe të vazhdueshëm për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët e Komunës sonë. Personat me Aftësi të Kufizuara përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së Komunës së Dragashit. Si shoqëri, si qeverisje lokale, kemi detyrim moral dhe ligjor për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjislationit në fuqi. Me hartimin e këtij plani ka qenë i përfshirë Grupi Punues nga drejtoritë e Komunës sonë, prindër dhe organizata joqeveritare. Ky Grup Punues ka zhvilluar tri takime fizike dhe disa takime online, duke diskutuar për përpilimin e këtij plani. Hartimi i planit është financuar nga UNICEF-i, dhe është implementuar nga Doën Syndrome Kosova, duke siguruar kështu një ekspertizë dhe mbështetje të nevojshme për realizimin e këtij plani. Unë në

pika të shkurta do t'i paraqes objektivat e këtij plani dhe çka synojmë të arrijmë. Si objektivi i parë është përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale për këtë kategori. Plani përmban masa konkrete për të përmirësuar shërbimet shëndetësore dhe sociale për PAK, përfshirë krijimin e një regjistri të veçantë për evidentimin e personave me aftësi të kufizuara dhe nevojat e tyre. Si objektivi i dytë është përmirësimi i qasjes fizike në objekte publike. Një aspekt thelbësor i këtij plani është përmirësimi i qasjes fizike në objektet publike. Plani synon të bëjë të gjithë ndërtesat publike – duke përfshirë shkollat, spitalet dhe qendrat administrative – të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Kjo do të thotë përfshirje në instalimin e rampave, ashensorëve, dhe përshtatjen e tualetëve dhe infrastrukturës tjetër për këtë kategori. Si objektivi i tretë është edukimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara. Është një aspekt i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve në institucionet edukativo-arsimore. Kjo përfshin ndërtimin e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë këta nxënës. Dhe pika e katërt është punësimi dhe trajnimi profesional dhe përfshirja e PAK në tregun e punës. Është një synim thelbësor i planit. Ne do të punojmë në krijimin e mekanizmave financiarë dhe programeve të posaçme për aftësim dhe riaftësim. Këto janë pra pikat e planit. Planin si material e keni, unë do të kërkoj nga ju që të votoni që të kalojë në Asamblenë Komunale. Faleminderit!

Xhemile Misinaj: Përsëritje për të gjithë! Unë deshta me e bo një pyetje të thjeshtë. Me sa dëgjova nga Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, thatë se është në plan edhe edukimi i nxënësve ose personave me aftësi të kufizuara. Por, a ka UNICEF- i ndonjë plan konkret për edukimin e familjarëve, për shembull? Sepse në Komunën tonë njih shumë familje ose familjarë që e mbajnë pak tabu ose të fshehtë nëse kanë në familjet e tyre persona me aftësi të kufizuara. Deshta me e ditë, a ka ndonjë plan të veçantë për edukimin e familjarëve që me ec përpara ose me i avancue këta persona.

Agon Baxhaku: Faleminderit për pyetjen! Kështu: UNICEF-i e ka financue hartimin e planit, jo projektin total. Këto objektiva kanë dalë nga zyrtarët komunalë, si nevoja se çka iu duhen personave me aftësi të kufizuara. Në Grup Punues ka qenë, për shembull, z. Ismajl Ramadani, prej Shoqatës HANDIKOS. Edhe ka qenë Ismail Qaflehi, prind i fëmijës me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ka qenë asistentja për fëmijë me nevoja të veçanta, e angazhuar në këtë drejtim. Për edukimin e prindërve, ne kryesisht jemi fokusue në edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Por, nuk do ishte e keqe që, ne të gjithë së bashku, pavarësisht planit, me avokue në këtë drejtim. Ne mund ta kemi një fushatë të përbashkët që me avokue në këtë drejtim. Sa i përket objektivit të tretë, ne këtu jemi lëshue në pikat që çka mund të bëjmë për këta fëmijë. Për shembull, Ekipi Vlerësues Pedagogjik është themeluar, ka marrë trajnimet e nevojshme. Disa familje kanë paraqit kërkesën për vlerësim pedagogjik për fëmijë me aftësi të kufizuara. Edhe shumë shpejt do të fillojë që të punojë kjo trupë profesionale për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, për nevoja pedagogjike, që asistentja për fëmijë me nevoja të veçanta të hartojë një plan individual, që pastaj plani individual, në bashkëpunim me prindërit dhe me akterët

tjerë shkollorë, pse jo edhe me këtë ekip, të krijojë mundësitë e nevojshme. UNICEF-i gjithashtu ka mbështet një klasë burimore në shkollën “Fetah Sylejmani”, unë ju kisha ftue me shkue me e pa, i përmban të gjitha pajisjet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilësdo kategori. Në bazë të kësaj, gjithashtu edhe angazhimin e asistentes për momentin e ka financue UNICEF-i. Tash shumë shpejt ajo do të kalojë – sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit – në kuadër të Komunës. Aty janë të gjitha pajisjet, kudo që ka nevojë ato pajisje munden edhe me u shpërnda, jo me nejt në shkollë. Nëse nuk ka person të verbër në shkollën “Fetah Sylejmani” po mund të ketë në një shkollë tjetër, pajisjet janë të lëvizshme. Te Pika 3.6, për shembull: Të organizohen fushata vetëdijesuese për popullatën. Na e kemi përfshirë edhe këtë si pikë. Besoj që munden me u bo fushatë, material vetëdijesuese nëpër media sociale dhe media lokale, gjithashtu mund të organizojmë bashkërisht, edhe ju si Asamble keni mundësinë me avokue në këtë drejtim. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Agon! A do edhe dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? A ka abstenim? Me 6 vota pro, zeri kundër dhe zero abstenim, edhe kjo pikë miratohet. Kalojmë në pikën e tretë e KPF-së, pika eventuale.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi, përshëndetjë për të gjithë! Pasi jemi në pikën eventuale, pata qef me e pyet kryetarin, në seancën e fundit që e patëm, të jashtëzakonshme, Komisioni vlerësues për dëmet e shkaktuara nga vërshimet ka qenë jo i plotë, pas votimit a është përfunduar ky Komision, përveç atyre listave që i kemi pas këtu, a ka edhe qytetarë të tjerë të future në listë, se atë ditë ka pas shumë të pakënaqur. Edhe, në qoftë se ka mundësi sot, s’po e di, s’po e di, po nesër në seancë me na pru është mirë, kryetar. Edhe, pas debatit që e kemi bo edhe që i kemi publikue këto listat nëpër rrjete sociale, e dish mirë, kryetar, pikërisht për ty ka pas akuza që nuk kanë shkue prej Komisionit nëpër disa qytetarë. Nuk kanë shkue për vlerësim të dëmeve. Aty në postim – e kam në foto këtu – është edhe një video, po është e fshime, nuk po due me shkue me emra, për hir se kam respekt për atë familje dhe janë kontributdhënës shumë të mëdhenj të partisë tuaj. Po ju direkt jeni të akuzuar se ju, si kryetar i Komunës, nuk e keni lënë Komisionin të shkon në shtëpinë e tyre dhe të bëhet vlerësimi i dëmeve nga vërshimet në Komunën e Dragashit. Po e shoh që e ke të paqartë, po kur të dalish këtu, dal një replikë, të kallxoj ma mirë për çka bëhet fjalë. Edhe e dyta, a ka mundësi nesër të na sillt një listë nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, për këto tri vitet e fundit, sa investime nëpër shtëpi kanë ndodhë – me siguri atë evidencën e ka Uzair Hamza, drejtori ose shefi – sa shtëpi janë ndërtue, sa subvencione për bletë janë dhënë edhe kush janë ata personat. Me siguri duhet me qenë publike ajo, se ato paret janë të buxhetit të Komunës së Dragashit, të buxhetit të Kosovës. Nëse nuk e ke pyetjen të kjartë, edhe një herë po ta them: Nesër, a ka mundësi, shefi i Zyrës për Kthim dhe Komunitete, të na bjer listën, për tri vitet e fundit, të personave të cilët janë investue për riatdhesimin e tyre nëpër shtëpi dhe për subvencione, bletë e shumë sende tjera. Se përndryshe, unë e di që e mohoni ju këtë, po unë edhe

zyrtarisht si asambleist, do ta bëj kërkesën zyrtare nesër, edhe për listën përfundimtare – në qoftë se nuk e sillni ju – edhe listën do ta kërkoj nga Zyra për Kthim dhe Komunitete, listën e personave të cilët kanë përfituar prej subvencioneve. Se nuk po due me paragjykie tash, po unë kam informata që aty, si të riatdhesuar, disa persona që janë në listën e zezë, e që janë disa persona që janë edhe të akuzuar për krime lufte. Kemi edhe nesër – s’po due sot – kemi një problem në fshatin Rrenc për rrugëm që na është prish, edhe varrezat. Po për këtë nesër do ta bëj, me foto e me kret, uji që po shkon, shumë mirë që po shkon për 15 fshatra, në bazen dëmet e mëdhaja janë bo, edhe në rrugë, edhe në varreza. Plus edhe nesër do të diskutojmë për në Arsim, kohët e fundit është një gjendje katastrofë, që s’kam qef me ia pa dyshmanit, e jo Komunës së Dragashit. Faleminderit! Nuk është shpifje, kryetar. Nuk je t’u e ditë, a po duosh me e lujt lojën. Qytetari – hyjsh në Facebook, është publike, krejt e dinë. Është nga katundi i drejtorit të Financave, e ke publikisht, krejt e dinë, veç ti s’po e dike, kryetar. Ani e përcjellish shumë Facebook-in. Qe unë po ta gjej. Është publike ajo, po më vjen keq me e përmend. Jo, ti i vogël je me m’dhënë sqarim mu këtu, ti i japish kryetarit sqarim, unë iu jap qytetarëve. Ti je pak më ulët një troh. Brruninë përjashta e matim, këtu politikë po bëjmë. Arijetë, a po e nalish, se i njëjti drejtor çdo herë tenton me aso, po të kam thënë, qeky smart drejtori – a po dësh pra me hy në debat – qe... ka qenë një video e publikuar edhe e kanë fshi, po më vjen keq. Vëllai i asambleistit tën është, Shahadin Mejzini. Bashkëfshatari i smart drejtorit tënd. Pastaj e ka fshi, edhe pastaj e ka postue. Shahadin Mejzin Profi: “Turpi ka mbarura, kjo është Komuna e Dragashit e Dr.Bexhet Xheladinint që ndan dhe bën compromise edhe në fatkeqësi duke favorizuar interesat personale. Kjo është publike, e kam shok edhe më ka dalë. Je akuzue që nuk e keni lënë me shkue Komisionin me bo vlerësime. Po, kryetar. Unë të thashë, me emër nuk pata qef, se Sefën e kam shumë shok, edhe pse mendon ndryshe nga unë politikisht, unë Sefën e kam mik të shpisë. Deshta mos me shkue me emër, po ju të detyroni, e keni lojë, po qe unë po ta qes. Shahadin Mejzini Profi, në Facebook e ke, me emër e ke. Një herë ke pas video, e ka fshi. Unë jam opozitar edhe due me i qit në pah të pabëmat e juaja. Pastaj e ka fshi, e ka shkruar. Turp! Edhe potencohet kryetari i Komunës, Bexhet Xheladini. Nuk i keni lejue qytetarët të vijnë të bëjnë... Komisioni me ardhë me bo vlerësimin. Veç unë momentalisht nuk kam rrjet, ta shohim mos po më vjen rrjeti. Ka edhe shumë qytetarë tjerë që ankohen. 16 Tetor: “Kryetar, ku janë vlerësuesit e dëmeve nga përmbytjet, pse i penguat të vijnë në vlerësim. Gjithmonë e shohim se të dobëtit jemi dhe mburremi duke menduar se po e shkelim të dobëtin. Harrojmë se pasojat mund të vijnë nga ata që i konsiderojmë të dobët. Përgjegjësia për fatkeqësitë i takon kreut të Komunës së Dragashit, me Zotin kamerë.” Ky është postim zyrtar. Po, kryetar. Unë e kam shok edhe qe ku e ke. “Pra lufton sa të mundet që të shantazhojë dhe t’i lërë anash nga LDK-ja njerëzit që kontribuuan me dekada, po përgjegjësia dhe pasojat është e tij. Koha e analfabetizmit ka mbaruar.”

Qamil Kolloni: Dëgjo, Artan, se je i frustruar. Po më vjen keq se një zyrtar me bo politikë me fjalë të çajtoreve, duke i pas organet, ti mundesh me parashtrur pyetje dhe mos me e lexue atë. Komisioni brenda fshatit edhe brenda Komunës, përpos që i kemi informue përmes Facebook-ut edhe fletës zyrtare, ne i kemi informue edhe me formularë që i kemi lënë në çajtore, pikërisht në çajtore të tij. Dhe qytetarët të cilët i kanë përmbush të gjitha kërkesat për me shkue me bo vizita Komisioni që janë shkaktue dëme, kanë qenë në atë listë. Në qoftë se qaj person ky që po fol me fjalë të çajtoreve, në qoftë se ka bo kërkesë në Komunë, unë si drejtor jap dorëheqje. Nuk jemi na për me lujt. Pse ky djalë bjer në fjalë të çajtoreve edhe të rrugëve, edhe do me bo politikë me fjalë të rrugëve duke shpif, edhe pse ai djalë është naiv atje, del e shkruan atje në Facebook se dikush e ka ndalë. Në qoftë se qaj person ka bo kërkesë si të gjithë qytetarët edhe e ka të protokolluar, unë si drejtor edhe si shërbyes i kryetarit në qeveri jap dorëheqje. Veç niveli i delegatit, kur e marrish votën e qytetarit, edhe vijsh si delegat edhe si përfaqësues, edhe merresh me një fjalor të rrugëve, ky është niveli ma i ulët, se kjo është shpifje. Dëgjo edhe një herë mirë: në qoftë se qaj person ka bo kërkesë zyrtare dhe të protokollume, si çdo qytetar tjetër, për vlerësimin e dëmit në Komunë të Dragashit, unë jap dorëheqje. Qaj person nuk ka bo kërkesë. Ti je tepër i vogël për me u marrë, vetëm dijs me fjalë të rrugëve me u marrë edhe kurgjo s’ dijs tjetër. Po i vogël je edhe ke me qenë i vogël gjithmonë. Po ti nuk dijs kurgjo! Se me qenë me dijtë, ti pak je ma ndryshe. Po, për ty shumë i madh jem.

Artan Loshaj: Është e turpshme, z.kryetar, me i thënë shpifje edhe me i nënvlerësue qytetarët. Ai për mu është një qytetar i Komunës së Dragashit, është një profesor, është një mësues që jep mësim, edhe me thënë shpifje, edhe me i thënë merret me fjalë të Facebook-ut, kjo është turp. Kjo është nënvlersim, kjo është marre. Shahadin Prof Mejzini ka qenë – unë e di që të kam thënë qeky ka me të çue në shpi edhe ka me të çue – ai ka qenë kandidat për drejtor në Shkollën “ULINA”. Nuk e ka marrë drejtori smart, se politikisht po shtyhen në fshat cili po del i pari. Ai është profesor, ai është mësimdhënës. Me thënë shpifje edhe me thënë me fjalë të Facebook-ut, është marre, duhet me i kërkue falje. Ai zyrtarisht në Facebook-un e vet – kryetar, ti merresh shumë me Facebook, se je marrë me VV’ në, me ne. Po, është e mundshme me ta pas vu bllok. Ai zyrtarisht – e ke në telefon, çele kryesuese, çelne delegatë, çele kryetar – ai publikisht e ka shkruar, unë nuk po shpifi. Ky me e nënvlerësue një qytetar, një votues 30-vjeçar të LDK-së, veç smart drejtori yt e bën. Po ai është një profesor, është një arsimtar që jep mësim fëmijëve dhe gjeneratave të reja. Ai nuk është një rrugaç, qysh po e mendoni ju. Ai është ma i shkolluet se ti, po këto ofendimet tua, ngrehi fjalët prapë, se me mu të del dardhë me bisht. Të lutem, unë kam ardhë në Komitet. Nëse të kondet me m’ngue mu – të kam thënë 100 mijë herë – mu populli më ka pru këtu, ty të ka pru kryetari sot, nesër të hek. A për ofendime, nuk të toleroj unë ty, këtu po bëjmë politikë. Të kam durue ty fjalët më të rënda të mundshme që i ke tu, q’at fjalor e ke ti. Unë thashë, mos e nënvlerësoni qytetarin. Ai nuk është një rrugaç sikur unë, se ai po thotë ai është një rrugaç

si ti. Nuk është rrugaç profesori, se ai mëson gjenerata të tëra. Është një qytetar i shkolluar, i edukuar, që është i frustruar me udhëheqësinë e LDK-së, pse nuk i është bo vlerësimi. Edhe e ka postue publikisht, unë nuk e nxora prej xhepit me bo shpifje. Me siguri edhe ti e ke shok në Facebook. A për këto fjalët e tij, është marre edhe duhet me iu kërkuje falje qytetarit.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, po dal te pika e Artanit. Unë kur e kam pa Shahadin Mejzini që e ka denoncue kryetarin e Komunës që nuk e ka lënë Komisionin, atëherë unë kam thënë pse Shahadin Mejzinit nuk keni shkue me ia bo, kanë thënë që në Komunën e Dragashit ai nuk ka bo kërkesë. Edhe ai, në qoftë se nuk ka bo kërkesë, ai mundet me u marrë me pastime çfarë të doje. Kështu që, unë për qato që i kam nënshkrue, unë nuk kam dashtë me nënshkrue shkaku i Shahadinit, por kanë thënë që nuk ka bo kërkesë. Edhe drejtori e tregoi që pa karkesë nuk mundet me u bo kurgjo. Unë për këtë pjesë edhe nuk due mo të diskutoj.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues! Të nderuar delegatë, të nderuar drejtor, përfaqësues i OSBE-së! Ju përshëndes të gjithëve! Unë nuk pata mendjen sot me dalë hiç me folë, por më nxiti Artani. Unë e kam një respekt, për ty, edhe për të ndjerin babain tënd, kemi qenë katër vite me një klasë. Gjithmonë kam dëshirë me ty me pas raporte të mira. Nga vetë fakti që sot dole edhe u more me gjëra që nuk është dashtë me u marrë, është dashtë një herë së pari me e vërtetue këtë lajm, a është i vërtetë a jo. Ke mund me ardhë edhe te unë, në zyrë të kryetarit, se unë këtë nuk e kam lexue. Unë për herë të parë po dëgjoj sot prej teje. Unë veç një send e di: Nuk e di a ka bo kërkesë ai. Po një send po të them, që unë me Komisionin mo nuk jam marrë hiç. Prej momentit kur u themelue Komisioni, mo vetëm i kam thirrë në takime, i kam kërkuje punë, i kam kërkuje që kërkujt mos me ia hëngër hakun, me e zbatue ligjin. E di që Komisioni nuk ka pas përvojë shumë, për atë dy herë kryetarin e Komisionit qeveritar e kam thirrë në takim, ai iu ka dhënë sqarime. Mua ma merr mendja që Komisioni në fund e ka bo një punë të shkëlqyeshme. Normal, kur hahet bukë bëhet edhe trosha. Ka mund me bo edhe gabime, edhe lëshime, pot ë gjithë ata të cilët kanë bo kërkesë, me Vendim të Asamblesë janë inkorporue në listën përfundimtare, edhe ajo listë është dorëzue në Qeveri, është dorëzue edhe në MAPL, është dorëzue edhe te kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve. Kryetari bashkë me Komisionin është duke u marrë me lëndën tonë. Nëse ka vërejtje na kthen atë për me e plotësue, nëse nuk ka, Komisioni vendos për shumën sa ka me iu ndihmue qytetarëve. Po për këtë rastin këtu, ne do ta sqarojmë nesër. Unë do ta thirri edhe Komisionin komplet këtu, edhe kryetarin e Komisionit, edhe ai ka me deklarue nëse unë u kam bërë presion Komisionit me shkue diku ose mos me shkue, ose me e vlerësue ma pak ose ma shumë. Unë për këtë jam shumë i pastër edhe askush nuk mund të dalë me m'akuzue sa i përket vlerësimin të dëmeve. Unë due ta falënderoj Komisionin, ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe, këtë punë e ka bo edhe jashtë orarit, edhe të dielave e të shtunave, edhe deri më tash nuk është kompenzue për këtë punë. Por do të mendojmë edhe në këtë drejtim, nëse do të kemi

buxhet, do t'i kompenzojmë, sepse ata kanë punuar edhe jashtë orarit. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, faleminderit për respektin ndaj meje, është i ndërsjellë, edhe për të mirë edhe për të keq. Faleminderit që edhe një herë ma ke thënë për të ndjerin prindin tem, keni qenë shokë klase. Edhe e dish shumë mirë, një telefonatë e kemi pas në 2016-tën për një problem, që më ke thënë për hir të të ndjerit që kemi pas raporte, a bon me e zbut gjendjen. E dish shumë mirë, për atë as nuk e diskutoj. Edhe nuk dola si kryetar me të nxit, po veç kam dalë me bo pyetje. Nuk kam ardhë kafe të çajtores, e të kafiçit. Kjo është e shkruar në rrjetet sociale. Ta bona pyetjen, e mora përgjigjen, s'e ke bo presion, kurgjo kërkuj. Është dashtë ti me dalë në fillim me e bo këtë reagim edhe mos me ardhë puna me i nxit debatet. Smart drejtorin po ma qesish këtu. Veç pyetje kam bo, kryetar. Jo bre kryetar, po ju ke reague VV-së e disa tjerëvem e tanëve, do reagime i ke bo, i kam lexue. Për atë të pyeta, se e di që i ke marak pak Facebook-in me e çelë, si çdo qytetar. Edhe ti je kryetar, duhet me iu dhënë përgjigje krejtve. Unë veç ta kam bo pyetjen a është e vërtetë, thaje që nuk është e vërtetë edhe ishte mbyllë qetu. Unë nesër, masi thaje listën, unë ta bona edhe pyetjen, nesër a do të jetë lista përfundimtare të cilën e ke dorëzue në Qeveri, që e ke dorëzue në MAPL, a është qajo lista që e kemi votue ne, apo mas votimit tonë keni fut në listë edhe qytetarë tjerë të Komunës së Dragashit. Këtë pyetje ta bona, ti nesër thaje po, edhe përgjigjen e dytë s'ma dhaje. Qat listën e investimeve të Zyrës për Kthim dhe Komunitete, të riatdhesuarit, kush janë personat të cilët... unë ta bëj edhe një herë si pyetje, mos të shkoj zyrtarisht, se ju keni thënë jemi shumë transparent na. Po nuk ka çka është e fshehtë, subvencionim kush ka marrë, kryetar. Nuk është e fshetë ajo, se ja Qeveria lokale iu ka dhënë, ja Qeveria qendrore iu ka dhënë qytetarëve. Subvencioni, në qoftë se ka marrë 10 mijë euro bletë dikush. Unë për shembull, që e ka biznesin gruaja ime, kam marrë subvencion para 15 vjetëve. Unë lypa prej kryetarit, prej Komisionit, se kryetari e ka formue Komisionin, a po? Edhe kryetari i fut në listë ata. Qaq dita bre Uran unë, më përmirëso ti, del më përmirëso. Se kryetati e ka bo Komisionin, edhe kryetari i shti në listë, në qoftë se ka shti, ata mas votimit. Se kanë thënë nuk është listë përfundimtare, n aka thënë krejtve qetu. Ani qe, faleminderit! Kryesuese, a na biesh listën nesër, a ka mundësi? Masi veç paska shkue zyrtarisht përmes Kuvendit në Qeveri edhe në MAPL. Me na pru qat listën, unë atë listën e parë e kam, edhe i kqyrim kush ka hi jashtë asaj. Domethënë, kryetar, nesër ti listën e Zyrës për Kthim dhe Komunitete s'po e biesh, domethënë sot po më bijka mu zyrtarisht me shkue me bo kërkesë. U sqaruam, kryetar, e kreva unë. Po mirë, masi po del me e sqarue këtë, pse s'po ma jep edhe këtë listën tjetër pra? Qat shefin e menazhosh ti, a po? Unë zyrtarisht po ta lypi ty. Unë të parit të Komunës po ia lypi, si delegat, si qytetar. Nuk po e lypi unë, qytetarët, se unë nuk jam Artani këtu, unë jam qytetari, unë në emër të qytetarit po e lypi. Unë po e lypi listën e tri viteve të fundit, të cilët kanë marrë subvencione dhe shtëpi, të qytetarëve të Komunës së Dragashit të cilët janë të riatdhesuar. Sa veta i keni kthye këtu edhe sa veta qëndrojnë këtu, sa vetave ju keni ndërtue shtëpi, ju keni dhënë bletë, ju keni dhënë subvencione, edhe ku janë ata,

a janë sot këtu edhe cilët janë ata persona. Se unë dyshoj – mos u kapni në fjalët e mia, se qy sa mirë po e them - dyshoj që në atë listë ka persona të cilët janë të akuzuar për krime lufte. E kuptove? Unë po dyshoj, qato po e lypi unë, se kur të dyshoj e lypi listën. Deri sot nuk kam dyshue, sot kam të drejtë me dyshue unë. Është një dyshim i jemi edhe po kam qef prej z.Uzair Hamzës – unë edhe në zyrë kam me i shkue, po deshta mos me të anashkalue ty, si më thaje pak më herët pse s'ke ardhë në zyrë me pyet. S'po shkoj te Uzairi, po të pyes ty. Vij edhe në zyrë të pyes. Edhe tash kam me shkue zyrtarisht, unë, Artan Loshaj, delegat i Kuvendit Komunal, bëj kërkesë listën e të subvencionuarve, të riatdhesuarve. Është një send i thjeshtë, është publike, kryetar. Menaxher ti e ke vu atë, si kryetar Komune. Të jep llogari direkt ty, paret janë të Kuvendit Komunal e janë të Qeverisë së Kosovës. Paret e qytetarëve janë ato.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë shihemi nesër në seancë! Faleminderit!